NEWSLETTER

KORRIK 2026

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Petra Winter vlerëson UBT-në: Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në nivel me universitetet evropiane

"Jam e bindur se UBT ka realizuar një transformim të kurrikulës që e vendos atë në të njëjtin nivel me universitetet homologe evropiane dhe është i pozicionuar shumë mirë për akreditimin nga EAEVE", është shprehur Petra Winter

Lexo në faqen 3

Arritjet dhe prioritetet strategjike të UBT në mbyllje të vitit akademik

Në përmbyllje të vitit akademik 2025–2026, Universiteti Bujqësor i Tiranës mbajti mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë Akademike dhe të stafit administrativ, ku u prezantuan zhvillimet më të rëndësishme institucionale, rezultatet e arritura gjatë vitit dhe prioritetet strategjike. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, prezantoi vizionin e universitetit për transformimin akademik, të mbështetur në modelin e Universitetit BOKU të Vjenës, duke theksuar se UBT po hyn në një epokë të re zhvillimi, të bazuar në cilësi, standarde ndërkombëtare dhe ekselencë akademike.

Lexo në faqen pasardhëse...

UBT prezanton arritjet dhe prioritetet strategjike në Asamblenë e Përgjithshme

Rektori prezantoi arkitekturën e re akademike të UBT-së për vitin 2026–2027, e cila përfshin 12 programe Bachelor, 17 programe Master Shkencor, 2 programe Master Ekzekutiv, një prej të cilëve i ri, si edhe 5 programe doktorature që po kalojnë procesin e rishikimit sipas standardeve të reja. Një pjesë e rëndësishme e prezantimit iu kushtua reformës së ofertës akademike, e cila, sipas rektorit, nuk synon reduktimin e programeve, por transformimin e filozofisë akademike, përmes rritjes së cilësisë, harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe krijimit të programeve të reja që i përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe zhvillimit të vendit.



Gjatë prezantimit u evidentua puna intensive e zhvilluar gjatë muajve të fundit për rishikimin e programeve të studimit, ku janë organizuar 30 workshope me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe ekspertëve të BOKU, ndërsa mbi 1,000 orë punë akademike janë investuar në analizimin, rishikimin dhe përgatitjen e programeve të reja Bachelor. Rektori Sallaku ndau gjithashtu rezultatet në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve ndërkombëtare. Aktualisht, UBT ka 24 projekte në fazën e firmosjes së kontratave për vitin 2026 me një normë suksesi prej rreth 90%.

Në vijim, u prezantuan edhe prioritetet strategjike të universitetit në fushën e kërkimit shkencor, të cilat përfshijnë konsolidimin e politikave institucionale për kërkimin, reformimin e sistemit të menaxhimit financiar, modernizimin e studimeve të doktoraturës sipas modelit BOKU, rritjen e pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës kërkimore dhe laboratorike. **Lexo më shumë...**

Presidentja e EAVE, Petra Winter:
FMV në të njëjtin nivel me universitetet evropiane

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka marrë një vlerësim të rëndësishëm nga Petra Winter, Presidente e Shoqatës Evropiane të Institucioneve të Arsimit Veterinar (EAEVE), e cila e cilësoi transformimin e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare si një arritje që e vendos universitetin në të njëjtin nivel me institucionet homologe në Evropë. Gjatë një retreat-i pune të zhvilluar në Vlorë, ku u analizua progresi i reformimit të kurrikulës, Winter vlerësoi përkushtimin e UBT-së në përafrimin e programit të studimit me Kompetencat e Ditës së Parë (Day One Competences – D1Cs) dhe standardet e EAEVE. "Jam e bindur se UBT ka realizuar një transformim të kurrikulës që e vendos atë në të njëjtin nivel me universitetet homologe evropiane dhe është i pozicionuar shumë mirë për akreditimin nga EAEVE", është shprehur Petra Winter në një postim në LinkedIn. Ajo thekson se ishte frymëzuese të shihte ndikimin konkret të standardeve të EAEVE në reformimin e kurrikulës, duke vlerësuar sinqeritetin dhe profesionalizmin me të cilin u identifikuan pikat e forta dhe sfidat gjatë procesit. Winter shprehu falënderime të veçanta për stafin akademik të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare për angazhimin dhe përkushtimin e tyre. **Lexo më shumë...**

UBT Talk

Bujqësia si sektor prioritar kërkon teknologji dhe inovacion

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla

Gjatë këtij episodi diskutohen politikat për modernizimin e bujqësisë, rritjen e konkurrueshmërisë së fermerëve shqiptarë, sigurinë ushqimore, përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit në prodhim, si edhe prioritetet e Shqipërisë në kuadër të integrimit evropian. Një pjesë e rëndësishme e bisedës i kushtohet bashkëpunimit mes institucioneve publike dhe UBT në nxitjen e kërkimit shkencor, transferimit të njohurive dhe përgatitjes së brezit të ri të specialistëve, të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe zonave rurale. **Shiko podcastin e plotë...**

Zgjidhni një diplomë që hap dyert e së ardhmes!

Në këtë episod të veçantë në UBT Talk, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, u drejtohet maturantëve që po bëjnë zgjedhjen e tyre për universitetin.

Ai thekson se në UBT studentët do të marrin një diplomë me standarde europiane, të krahasueshme me atë të kolegëve të tyre në vendet e Bashkimit Europian.

Me një kampus modern, programe të reformuara dhe lidhje të forta me tregun e punës, UBT synon t'u ofrojë studentëve mundësi reale për punësim dhe zhvillim profesional pas diplomimit. **Shiko podcastin e plotë...**

Universiteti Bujqësor i Tiranës marrëveshje bashkëpunimi me UBT në Kosovë

Universiteti Bujqësor i Tiranës vijon të zgjerojë rrjetin e bashkëpunimeve ndërkombëtare, duke nënshkruar një marrëveshje partneriteti me UBT në Kosovë. Marrëveshja u firmos nga Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, dhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, me synimin për të forcuar bashkëpunimin në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, inovacionit dhe shkëmbimit akademik.

Në kuadër të këtij partneriteti, një delegacion i Universitetit Bujqësor të Tiranës, i kryesuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, zhvilloi një vizitë zyrtare në kampusin e UBT-së në Kosovë. Gjatë vizitës, delegacioni u njoh nga afër me Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik, laboratorët, qendrat e inovacionit dhe infrastrukturën moderne të universitetit, duke shkëmbyer përvoja mbi zhvillimin institucional dhe praktikat më të mira në arsimin e lartë. Në takimin mes drejtuesve të dy universiteteve u diskutuan mundësitë për zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, hartimin e programeve të përbashkëta akademike, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit në fusha me interes të ndërsjellë për të dy institucionet. **Lexo më shumë...**



Editorial/ Pse të rinjtë shqiptarë duhet të zgjedhin Bujqësinë!

Të gjithë duan të kenë një fermë. Një "inkubator" ku mund të jetojnë më të qetë, larg kaosit urban dhe ku mund të shpalosin pasionin për lulet, pemët dhe kafshët. Disa e mendojnë ta ndërtojnë kur të pensionohen dhe disa të tjerë të nisin jetën nga aty. Prej shumë vitesh, bujqësia është parë nga shumë të rinj si një sektor i të kaluarës që lidhej ngushtë me punën e mundimshme fizike dhe mundësi pune të kufizuara dhe me pagesa të ulëta. Por perspektiva tregon se fermeri i së ardhmes do të kalojë më shumë kohë në laptop sesa mbi një traktor. Bujqësia nuk ka të bëjë vetëm me bujqësinë. Ajo ofron gjithashtu mundësi karriere në marketing, komunikim, biznes, shkenca mjedisore, mjekësi veterinare, teknologji ushqimore dhe tregti ndërkombëtare.

Realiteti tregon se në Shqipëri por jo vetëm, bujqësia është një nga sektorët më strategjikë dhe të kërkuar. Bujqësia vazhdon të jetë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare, duke kontribuar me rreth 18% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), një nivel shumë më i lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian. Një pjesë e madhe e shqiptarëve e kanë aktivitetin kryesor nga ata marrin të ardhurat. Por sot, një nga sfidat më të mëdha të bujqësisë është mungesa e specialistëve të rinj. Mosha mesatare e fermerëve në Europë sa vjen dhe rritet dhe kjo dukuri po bëhet prezente edhe në Shqipëri. Tregu sot po kërkon gjithnjë e më shumë agronomë, veterinerë, inxhinjerë mjedisi, teknologë ushqimorë apo ekspertë të zhvillimit rural.

Sot shati, parmenda, lopata e shumë vegla të tjera pune po zëvendësohen me teknologji të reja të cilat japin shumë shpresë që bujqësia mund të ecë shumë më përpara. Arsyeja më e fortë pse të rinjtë duhet të studiojnë bujqësi lidhet me transformimin teknologjik të sektorit. Dronët për monitorimin e kulturave, AI në analizimin e të dhënave, sensorët e ujitjes e shumë teknologji të reja po përdoren duke sjellë kështu një modernizim të sektorit dhe lehtësim në punën e përditshme të fermerëve. **Lexo më shumë...**

UBT promovon ekselencën akademike

Gjatë muajit qershor, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit u zhvillua prezantimi publik i aktivitetit kërkimor-shkencor të Prof. Asoc. Dr. Edmond Hala, pedagog pranë Departamentit të Akuakulturës dhe Peshkimit, në kuadër të procedurës për fitimin e titullit akademik “Profesor”. Gjatë prezantimit, Prof. Asoc. Dr. Hala paraqiti rezultatet e punës së tij disa vjeçare në fushën e akuakulturës dhe peshkimit, me fokus në kërkimet mbi biologjinë riprodhuese dhe menaxhimin e specieve detare me rëndësi ekonomike. Ndër studimet e prezantuara spikati kërkimi mbi maturimin riprodhues të peshkut meagre (Argyrosomus regius) në kafaze lundruese, i cili vlerëson nëse individët e prodhuar në hatchery dhe të rritur në kushte normale komerciale arrijnë maturimin gonadal dhe riprodhohen natyrshëm. Ky studim u realizua në bashkëpunim me laboratorin e Histologjisë të Departamentit të Mjekësisë Veterinare të Universitetit të Barit “Aldo Moro”, Itali.

Së fundmi në UBT u zhvillua edhe mbrojtja publike e tezës së doktoraturës me temë “Vlerësimi i përshtatshmërisë së tokave për kultivimin e drithërave dhe mekanizimin bujqësor duke përdorur analizën me shumë kritere bazuar në GIS”, nga MSc. Olsid Mema, nën udhëheqjen shkencore të Prof. Asoc. Dr. Etleva Jojiç. Punimi trajton përdorimin e teknologjive moderne të Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe analizës me shumë kritere për identifikimin e zonave më të përshtatshme për kultivimin e drithërave dhe planifikimin e mekanizimit bujqësor. Gjatë mbrojtjes publike, puna kërkimore u vlerësua nga komisioni për cilësinë shkencore, qasjen inovative dhe përdorimin e metodave bashkëkohore të analizës hapësinore.

Lexo më shumë...

UBT akordon gjashtë tituj akademikë "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar"

Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik (KPPA), në bashkëpunim me Drejtorinë e Shkencës dhe Promovimit Akademik (DSHPA) në UBT zhvilloi mbledhjen e radhës, në kuadër të procedurave për promovimin akademik të personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë mbledhjes, Komisioni shqyrtoi dosjet dhe dëgjoi prezantimet në gjuhën angleze të gjashtë kandidatëve në kërkim të fitimit të titujve akademikë "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar". Pas vlerësimit të veprimtarisë akademiko-shkencore të secilit kandidat dhe verifikimit të përmbushjes së standardeve të kërkuara, Komisioni vendosi me unanimitet të plotë akordimin e gjashtë titujve akademikë.

Titulli akademik **"Profesor"** iu akordua:

- Prof. Dr. Oltjana Zoto, staf akademik në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- Prof. Dr. Skënder Uku, staf akademik në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- Prof. Dr. Edmond Hala, staf akademik në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Ndërsa titulli akademik **"Profesor i Asociuar"** iu akordua:

- Prof. Asoc. Dr. Dhurata Shehu, staf akademik në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- Prof. Asoc. Dr. Jonida Biçoku, staf akademik në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan;
- Prof. Asoc. Dr. Teuta Çerpja, staf akademik në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Lexo më shumë...

Sesion informues në UBT mbi grantet kërkimore AADF–BMF për stafin akademik

Universiteti Bujqësor i Tiranës mbajti një sesion informues kushtuar programit të granteve kërkimore të financuara nga Albanian-American Development Foundation (AADF) në bashkëpunim me Butrint Management Foundation (BMF). Aktiviteti synoi të informojë stafin akademik dhe kërkimor të UBT-së mbi mundësitë e financimit, kriteret e aplikimit dhe fushat prioritare të mbështetjes, duke nxitur përfshirjen e studiuesve të universitetit në projekte kërkimore me ndikim kombëtar dhe ndërkombëtar. **Lexo më shumë...**

UBT mirëpret entomologun amerikan Dr. Vinton Thompson

Universiteti Bujqësor i Tiranës, përmes Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve, në bashkëpunim me Institutin e Burimeve Gjenetike të Bimëve, mirëpriti në një leksion të hapur Dr. Vinton Thompson, entomolog në Muzeun Amerikan të Historisë Natyrore në Nju Jork, SHBA. Leksioni u fokusua te insektet vektorë dhe roli i tyre në përhapjen e Xylella fastidiosa, një nga bakteret fitopatogjene më të rrezikshme në botë, që prek kultura strategjike si ulliri dhe hardhia. Leksioni i tij ofroi njohuri të vlefshme mbi biologjinë e insekteve vektorë, epidemiologjinë e sëmundjes, si edhe përvojat ndërkombëtare në monitorimin dhe menaxhimin e këtij patogjeni me rëndësi të madhe ekonomike për bujqësinë. **Lexo më shumë...**